

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Nis seanca në Hagë për krerët e UÇK-së, Kadri Veseli i buzëqeshur, Hashim Thaçi shihet i qetë
ADRESA	https://newsbomb.al/rajon/nis-seanca-ne-hage-per-kreret-e-uk-se-ne-hage-kadri-veseli-i-b-uzeqeshur-ha-i401317
BURIMI	newsbomb.al
GJENDJA	edited

KOHË


KAPUR NGA NE	16 shtator 2026, 08:14:30 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	16 shtator 2026, 08:11:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	090d0c9335c824f57bf0b9b5f7a59dda0213e566a1e9282a34c4192678077524
TEKSTI	41d9249ee9c6e401445ea2986db43f59f7cbdfafa03312849aad2453fc5152d17
PAMJA	a8c7fa3bc0cc12b12f5ce761eb4d5cc76e08098b5d2e5b0ca1e9a8277087d698

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	704c2994d0f87f976f7f0fa2dcdbd8023f33ee7621e748af561e9dfb0a7192ccb
E MËPARSHMJA	e4405a586c4092e292dd54d30c70903d9f78daca78e85828f011becfb8f39458
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/704c2994d0f87f976f7f0fa2dcdbd8023f33ee7621e748af561e9dfb0a7192ccb>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

12 numrat e parë FALAS!
Version PDF

Abonohu te Revista

[Kreu](#)
[Politikë](#)
[Aktualitet](#)
[Ekonomi](#)
[Kulturë & Art](#)
[Rajon](#)
[Sport](#)
[Bota](#)
[Showbiz](#)
[SocialBomb](#)


Çështjet kryesore

Haga vendos sot për katër ish-krerët e UÇK-së!

Arrestohet Ergys Agasi

"Retreat"-i i qeverisë në Pogradec!

Rajoni

16 Shtator 2026, 10:11

Nis seanca në Hagë për krerët e UÇK-së, Kadri Veseli i buzëqeshur, Hashim Thaçi shihet i qetë



Shkruar nga Newsbomb



Pamje nga seanca

Ka nisur në Hagë seanca për procesin gjyqësor ndaj ish-krerëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, në një nga momentet më të shumëpritura të këtij procesi. Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Rexhep Selimi dhe Jakup Krasniqi janë para trupit gjykues të Dhomave të Specializuara të Kosovës, ku sot pritet të shpallet aktgjykimi i shkallës së parë.

Në pamjet nga sala e gjyqit, Kadri Veseli është parë i buzëqeshur, ndërsa Hashim Thaçi është shfaqur i qetë në momentet e para të seancës. Edhe Rexhep Selimi dhe Jakup Krasniqi ndodhen në sallë, përballë trupit gjykues.

Seanca është e hapur për publikun dhe po transmetohet përmes platformave të Dhomave të Specializuara të Kosovës, me një vonesë prej rreth dhjetë minutash. Transmetimi po zhvillohet në tri gjuhë, shqip, anglisht dhe serbisht.

Aktgjykimi që pritet të shpallet sot vjen pas një procesi të gjatë gjyqësor ndaj katër ish-drejtimesve të UÇK-së.

Thaçi, Veseli, Selimi dhe Krasniqi përballen me akuza për gjashtë pika për krime kundër njerëzimit dhe katër pika për krime lufte. Të katër ish-krerët e UÇK-së janë deklaruar të pafajshëm ndaj të gjitha akuzave.

Pas gati gjashtë vitesh në paraburgim në Hagë, Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Rexhep Selimi dhe Jakup Krasniqi presin sot shpalljen e aktgjykimit në procesin gjyqësor që nisi në prill

Revista



Abonohu tani dhe lexoje >

Lajmet e fundit



Politikë

Diskutimet për Reformën Territoriale, Rama mbërrin në Korçë! Në takim shfaqet edhe djali i tij Gregu (VIDEO)



Aktualitet

LAJMI I FUNDIT/ Bie akuza e krimeve kundër njerëzimit për katër ish-krerët e UÇK-së

Zbulu më shumë artikuj >

të vitit 2023. Të katër ish-drejtnesit e UÇK-së u arrestuan në nëntor të vitit 2020 dhe u transferuan në qendrën e paraburgimit në Hagë më 4 dhe 5 nëntor të po atij viti. Procesi ndaj tyre lidhet me akuzat për krime lufte dhe krime kundër njerëzimit, të cilat sipas aktakuzës dyshohet se janë kryer nga anëtarë të UÇK-së nga të paktën marsi i vitit 1998 deri në shtator të vitit 1999.

Këshilluar për ty



Haga vendos sot për katër ish-krerët e UÇK-së!

Krimet e përfshira në aktakuzë lidhen me disa zona të Kosovës, por edhe në Kukës. Prokuroria pretendon se viktimat ishin qindra civilë dhe persona që nuk merrnin pjesë në luftime dhe se në shënjestër ishin persona të dyshuar si kundërshtarë të UÇK-së.

Aktakuza përmban gjithsej dhjetë pika. Gjashtë prej tyre janë akuza për krime kundër njerëzimit: përndjekje, burgosje, akte të tjera çnjerëzore, torturë, vrasje dhe zhdukje me forcë. Katër të tjerat janë akuza për krime lufte: arrestim dhe ndalim i paligjshëm ose arbitrar, trajtim mizor, torturë dhe vrasje.

Sipas aktakuzës, viktimat thuhet se kanë qenë serbë, romë, persona të dyshuar për bashkëpunim me autoritetet serbe, por edhe shqiptarë të konsideruar si kundërshtarë politikë ose si persona që nuk mbështesnin UÇK-në. Prokuroria pretendon se këto krime ishin pjesë e një sulmi të gjerë dhe sistematik ndaj personave që dyshoheshin se ishin kundër UÇK-së.

Pikë e rëndësishme në këtë proces është se katër të pandehurit nuk akuzohen thjesht sepse kanë qenë pjesë e UÇK-së apo sepse kanë mbajtur poste drejtuese. Aktakuza i ngarkon me përgjegjësi penale individuale, në formë të ndryshme të përgjegjësisë penale, për krimet e përfshira në aktakuzë. Kjo do të thotë se gjykata duhet të vlerësojë përgjegjësinë e secilit prej tyre, mbi bazën e provave të paraqitura gjatë procesit.

Të katër të pandehurit janë deklaruar të pafajshëm për akuzat. Prokuroria e përfundoi paraqitjen e provave në prill të vitit 2025, ndërsa procedura e provave u mbyll në dhjetor të vitit 2025. Në gjykim kanë dëshmuar 134 dëshmitarë, prej të cilëve 125 janë thirrur nga Prokuroria, dy nga mbrojtja e viktimave dhe shtatë nga ekipet e mbrojtjes. Deklaratat përfundimtare u mbajtën në shkurt të vitit 2026.

Sondazh

Poll

Lexo gjithashtu



Trupi gjygues nis leximin e aktgjykimit ndaj Thaçit, Veselit, Selimit e Krasniqit, Smith: Nuk po gjykojmë luftën e UÇK-së



Rajoni

Vendimi për ish-krerët e UÇK-së, kongresmeni amerikan ngre shqetësimin: Në Hagë ka ndikim politik

E Mërkurë 10:27



Rajoni

Mediat serbe për gjyqin vendimtar ndaj ish-krerëve të UÇK-së: Verdikti po pritet me shumë interes dhe pasiguri


E Mërkurë 10:19 Newsbomb



Rajoni

E Mërkurë 10:07 Newsbomb

PAS PAK VENDIMI/ 270 dëshmitarë, 234 ditë dëgjësash, 29,000 faqe dëshmi, çfarë ka ndodhur në gjyqin ndaj Hashim Thaçit



Rajoni

"Jam krenar për babin", djali i Jakup Krasniqit para nisjes së seancës: Besoj se sot do të lirohen


E Mërkurë 09:56



Rajoni

KUSH janë katër gjyqtarët që kanë në dorë fatin e katërshes së UÇK-së, të njëjtët do të marrin vendimin ndaj Thaçit për pengim drejtësie

E Mërkurë 09:29 Newsbomb



Rajoni



E Mërkurë 09:22

Shqiptarët sytë nga Haga, Albin Kurti i "frikësuar"?! Shton masat e sigurisë dhe i ngre gardhet para Kryeministritsë (E PLOTË)



Rajoni

Vendimi final për çlirimtarët e Kosovës, shqiptarë nga mbarë bota "zbarkojnë" para Gjykatës së Hagës, mbërrijnë dhe familjarët e katërshes

E Mërkurë 08:44 Newsbomb



Rajoni

Shqiptarët me sy e veshë nga Haga, vajza e Jakup Krasniqit emocionin me postimin, e bija puth portretin e gjyshit: Nuk jam e lirë pa lirinë tënde

E Mërkurë 08:02 Newsbomb



E Mërkurë 07:17 Newsbomb

Tre orë para momentit historik për katërshen e UÇK-së, qytetarët e gdhijnë në sheshin "Skënderbeu": Do jemi këtu deri në LIRI (PAMJE)



Rajoni

Prishtina në pritje të vendimit historik për ish-krerët e UÇK-së! Qytetarët mbushin sheshin "Skënderbeu", me flamuj në duar presin "ditën e re të lirisë"



Rajoni

Kosova "sy e veshë" nga Haga nesër, spitali kryesor i Prishtinës merr masa

E Martë 20:34



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.